



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 13-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 29.01.2019 (e martë), në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 13. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 14. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 15. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 16. Arben Kabashi, PDK; |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 17. Ajshe Metaj, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 18. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 19. Agron Avdijaj, VV; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 20. Lavdiqe Bujupaj, VV; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 21. Arif Elshani, IQ; |
| 10. Naim Imeraj, AAK; | 22. Radoš Repanović, SL; |
| 11. Nexhmedin Balaj, AAK; | 23. Radenko Belošević, RB dhe |
| 12. Muhamet Ukaj, AAK; | 24. Slaviša Maliković, SM. |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe Kryetari z.Haki Rugova, Nënkyryetari i Komunës z.Agim Ademaj, drejtore të drejtive komunale, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjtë gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z.Qaush Balaj.

Procesverbal

Kryesuesi, përshëndeti të pranishmit dhe për këtë mbledhje propozoj këtë :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shpallja në diskutim publik e Planit Zhvillimor Komunal 2018 -2026 (PZHK);
4. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër (tetor-dhjetor) 2018;
5. Shqyrtimi i Raportit të punës të Kryetarit për vitin 2018;
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018;
7. Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores Komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba dhe
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi, pyet nëse ka diçka dikush për këtë rend ditë? Fjalën e ka kérkuar Arif Elshani.

Arif Elshani, përshëndeti të pranishmit. Mbledhjen e nënitorit kam bërë kérkesë për tri pikë të rendit të ditës por kam marrë një njoftim për dy pikë. Kisha lutë që në pikën e fundit të hynë edhe kérkesat e mijë për muajin nëntor. Është për ujësjellësin e Banjës sepse nuk ka ujë, familjet më asistencë sociale a financohen dhe pikë e tretë për qendrën urbane të Saradranit? Unë nuk kam marrë përgjigje dhe kisha pas dëshirë që këto të mbesin për pikën e fundit të rendit ditës.

Kryesuesi, në pikën për pyetje nga anëtarët e kuvendit mund të shtrohet pyetja që nuk keni marrë përgjigje. Kush është që të vazhdohet më këtë rend ditë?

Kuvendi me votim unanim, pa asnje votë kundër dhe pa abstenime miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje mungojnë tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë zëvendësuar nga KQZ-ja për shkak se ende nuk janë certifikuar. Gjithsej në mbledhje janë të pranishëm 24 (njëzetë e katër) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdoi me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal?

Procesverbal

Pasi që nuk pati vërejtje dhe diskutime, kuvendi me 18 vota për, 3 abstenime, miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Radoš Repanović, Radenko Belošević, Slaviša Maliković dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e Planit Zhvillimor Komunal 2018 -2026 (PZHK). Kjo pikë ka kaluar edhe në KPF, keni rekomandimin. Fjalën ja kaloj Kryetarit z.Haki Rugova.

Kryetari, përshëndeti të pranishmit. Pasi është mbledhja e parë për këtë vit ju dëshiroj sukses këtë vit. Do dëshiroja të kemi bashkëpunim të mirë më ju. Fjalën ja kaloj ekipit që të bëjë prezantimin e këtij projekt-plani. Mendoj së është një punë tepër e mirë, fjalën ja kaloj Drejtorit të Urbanizmit Besart Dreshaj.

Besart Dreshaj, falënderon për fjalën dhe përshëndeti të pranishmit. Drejtoria e Urbanizmit i ka kryer të gjitha procedurat e kërkua e për Planin Zhvillimor të Komunës së Istogut. Asambleja e mandatit të kaluar më datë: 29.01.2016, ka nxjerr Vendimin për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal. Komuna e Istogut duke parë si plan shumë strategjik dhe zhvillimor i ka kryer të gjitha procedurat dhe ka caktuar Kompaninë e Urban Plus më Profesor Ilir Gjinolli, i cili është prezent këtu. Ndërsa më planin ju kemi drejtuar edhe Ministrisë së Ambientit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë ka nxjerr Vendim me datën: 27.12.2017, janë kryer të gjitha procedurat dhe mund të vazhdohet më implementimin e Planit Zhvillimor për Komunën e Istogut. Fjalën ja kaloj Ilir Gjinollit për prezantim.

Ilir Gjinolli, bëri prezantimin e draft-propozimit për Planin Zhvillimor për Komunën e Istogut.

Kryesuesi, të nderuar anëtar të kuvendit nëse ka dikush diçka? Fjalën ja kaloj Agron Avdijajt e mandej Arif Elshani.

Agron Avdijaj, falënderon për fjalën dhe për prezantimin. Meqenëse unë nuk jam i fushës nuk kisha mund më u ndal më ndonjë pyetje shumë konkrete. Megjithatë diçka që më shumë po më shqetëson është më shumë Propozim-Vendimi. Është paraparë që diskutimi publik të behët në katër zona, Istog dhe tri zona tjera por jo nga zona lindore. Lihet përshtypja që po vazhdon prapë e njëjtë qasje që pjesa lindore, pjesa e mbi vadës sikur po anashkalohet. Unë e dijë se për nga numri i banorëve është më pak së zonat tjera por përderisa Plani Zhvillimor Komunal e trajton kryesisht shtrirjen hapësinore, unë konsideroj se ajo pjesa lindore ka shtrirje më të madhe. Mospërfshirja në diskutim publik të paktën Rakoshi, është shumë shqetësuese dhe nuk ish dashtë të mos përfshihet në propozim-vendim. Nuk e di a është trajtuar apo është lënë më ndonjë qëllim tjetër apo ka ikur si detaj?

Ilir Gjinolli, ndoshta ka ikur sepse jo vetëm në pjesën lindore por kudo që ka nevojë do të diskutohet. Nuk jemi të interesuar aspak më kalu as ne as komuna. Mendoj së nuk ka vlerë, komuna të vendos ku do që dëshiron më prezantu. Të gjithë i kanë të drejtat e njëjta dhe interesat legjitime. Planifikimi i cili shkakton konflikte është planifikim jo i mirë.

Agron Avdijaj, unë konsideroj lehet përshtypja nuk e dijë kur hysh në detale te projektit. Ideja që popullata, vendbanimet i përqendron në ato zona ku zhvillohet ma shumë. Trendi është shumë i madh i largimit të familjeve prej atyre zonave. Nuk është trend i largimit prej Vrelle, Banje, Gurraçoci për të ardhur në Istog. Për këtë arsyе për mos të ardhur deri në atë nivel ish dashtë fokus më i veçantë në atë drejtim mos të jetë me bërë investime kur të zbraket krejt aty.

Kryetari, unë pyetjen e kuptova më shumë së është drejtar ndaj nesh. Nuk është ideja me e diskriminuar askënd, në pjesën e mbi vades që e quajmë ne edhe atje do të bëhet një diskutim. Kemi kohë dhe pse mos të bëhet? Ato janë futur si subqendra. Nuk kam pasur kohë shumë por e pashë që stafi i brendshëm dhe kam vërejtje në staf që nuk ju ka dhëne informacione të vazhdueshme, ju si kompani që e keni bërë projektin. Shembull e pashë projektin e ujësjellësve ka gabime katastrofë, kanalizime dhe ka gabime tjera. Ne do të angazhojmë mbledhje me stafin pa ju apo edhe me ju në rastin tjetër, i kisha lut drejtorët të lexojnë me kujdes. Duke filluar nga fjala bashkësi lokale, të thotë dikush a ekziston me ligj? Ju e keni cekur se mungon uji në disa vendbanime? Cilat janë këto vendbanime? Bashkësi lokale pse kur nuk ka tash term të tillë. Në statut te komunës nuk ka bashkësi lokale, në dokumente zyrtare. Urojë që debatet të behën mirë.

Ilir Gjinolli, të dhënat për ujësjellës dhe kanalizime i kemi marrë nga Ndërmarrja publike rajonale. Kanë mundur të mos të janë të përditësuara. Çështja e emërtimeve është pak e rëndësishme sa është shpërndarja e numrit, trafikimet edhe pozitës gjeografike në territorin.

Kryetari, problem me ujitje është cekur Koshi, që është vend i lartë dhe nuk ka problem asnjëherë me ujitje. Këtu përmendet që nuk ka rrjet në disa vende e që nuk kanë problem të tillë. Banja ka problem me ujë dhe është projekti që do të behët.

Kryesuesi, fjalën e ka Arif Elshani.

Arif Elshani, falënderon profesorin për prezantim dhe materialin voluminoz. Puna e profesorit është e përfshire në të gjitha poret e jetës. Por disa shënimë që ka përdor profesori janë të mangëta. Për atë arsyë po jap disa shënimë. Kur është fjala të komuna në si bashkësi lokale gjithkund përmendët Dobrusha e jo Staradrani, që në vitin 2014 kemi nxjerr një vendim që Staradani të jetë qendër urbane. Unë kisha propozuar që edhe Staradrani të përfshihet në këtë projekt si qendër urbane për Komunën e Istogut.

Procesverbal

Në të ardhmen uroj që Staradrani të jetë ai që meriton. Unë kam hasur edhe në disa vërejtje të mia që ndoshta kanë vend për tu hartuar por varet nga stafi komunal. Zona të veçanta i kemi tri, që janë kryesisht të fesë ortodokse e kemi: Manastirin në Istog, Kishën ne Gjurakoc dhe Manastirin në Studenicë. Sipas kësaj shohë së shumë mirë i kemi disa vende në mbrojtje. Shembull vendbanime në mbrojtje e shohë së e kemi Urën e Zallqit, që është e viti 1867. Pse mos të kërkojmë të hyjë në mbrojtje të veçantë edhe kulla të vjetra. Te mos na mbesin vetëm tri histori që mbesin për dhjetë vite në këtë plan. Mendoj të kërkohet nga stafi komunal nga profesori që shembull përmenda urën, që edhe ajo të hyjë në mbrojtje të veçantë. Pastaj janë futur disa kompani pse mos të përmendët edhe kompania Graniti, që është një nga kompanitë më të vjetra. Janë katër kompani më të vjetra që janë një ndër kontribuesit edhe të paraluftës, kanë shumë punëtorë. Këtu mbesin vetëm katër kompani e që meritojnë edhe të tjera të futën në këtë plan. Kemi edhe monumente kulturore në mbrojtje, kemi disa kulla disa mullinj por sa unë e pashë është Kulla e Hysen Elshani në Staradran, që disa nga ju e dinë që është një kullë e rrënuar e kallur dhe disa herë është bërë kërkesa që të hyjë në mbrojtje dhe është pa kulm. Mendoj se ish dashtë të paraqitet këtu, për me shumë të mirën shënimet dhe Kryetari me stafin e vetë, të konstatoj a është kjo gjendje apo nuk është? Mandej janë edhe varret e Stardranit. Te ujësjellësi e ceku Kryetari edhe unë kam cek sa herë që Banja nuk ka ujë dhe nuk e kam parë as në projektet e ardhshme. Është qendër urbane dhe si qendër turistike dhe mendoj të behët një plan i fizibilitetit për Banjën dhe duhet të behët një zgjedhje si komunë. Falënderoj dhe e përgëzoj profesorin për këtë plan por mendoj që disa ndryshime ja vlejnë.

Ilir Gjinolli, lidhur me trashëgiminë kulturore janë kompetenca të ndara në nivel lokal dhe qendror. Shohim nëse ndonjëri nga projektet që propozuat nëse është i listuar. Komuna nuk mundet në mënyre vetanake të bëjë këtë. Ardita i ka marr shënimet dhe do ju japim përgjigje.

Kryesuesi, fjalen e ka kërkuar Naim Imeraj.

Naim Imeraj, falënderon për fjalen Kryesuesin dhe përshëndeti të pranishmit. Falënderon profesorin për këtë prezantim, po them fillestar të kësaj faze. Kjo sigurisht është përcaktuar edhe me hapa ligjor të këtij Plani Zhvillimor Komunal. Unë kam propozim që përmes Kryesuesit që propozim-vendimi i Kryetarit për hapjen e diskutimit publik përkatësisht shqyrtimit publik të projektit që na është prezantuar neve, në nenin 2 pika 3 t'i shtohet edhe Rakoshi dhe Staradrani. Në mënyrë që kjo ta ketë anën formale të vlefshme edhe për ju. Për shkoqitjen e materialit besoj që i kam disa çështje por besoj që kemi mundësi dhe hapësirë që në fazat e diskutimit publik të japim maksimumin.

Kryesuesi, dikush tjetër e ka kërkuar fjalen.

Jehona Haxhijaj, përshëndeti të pranishmit. Edhe unë kam vërejtur të njëtin detal sikurse kolegu që e tha. E vërejta që fshati Rakosh ka mbetur i diskriminuar dhe i lëne

Procesverbal

anash me qellim apo pa qellim ajo është çështje e juaja. Mirëpo kërkoj që gjithsesi të mbahet diskutim publik në atë fshat sepse edhe ata banorë kanë drejtë të jenë në dijeni rrëth këtij plani zhvillimor dhe se fundit janë banorë të kësaj komune. Kërkoj të mbahet një diskutim publik atje.

Kryesuesi, fjalën ja kaloj Arben Kabashit.

Arben Kabashi, përshëndeti të pranishmit, pajtohem me kolegut Naim. Pasi që do të del në diskutim publik aty mblidhen edhe kërkesat edhe mundet të kompletohet ky plan zhvillimor për Istogun. Unë një vërejtje më shumë ë pata në një vendim që është marrë mandatin e kaluar për qendrat urbane. Nuk e dijë nëse Saradrani është qendër urbane apo nuk është qendër urbane? Për të qenë qendër urbane ne i dimë edhe procedurat si shkojnë, me statut të komunës në bazë vendimit që kemi marr thuhet së është qendër urbane? Realisht duhet të merret pëlqimi edhe nga ministria. Kjo është kompetencë e Kryetarit dhe drejtorisë të na sqarojnë mirë sot.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Zenel Shatri.

Zenel Shatri, përshëndeti të pranishmit, kam pyetje për profesorin. A pëson ndonjë ndryshim apo keni bëre plan se bjen autostrada, nëse po ish dashtë nga ky diskutim publik?

Ilir Gjinolli, ne nuk kemi qenë shumë të informuar për këto procese dhe në mbledhjen e fundit të KPF-së e kuptuam. Me siguri në këto dy muaj mund të pritet një vendim. Nëse vendos qeveria ne duhet të marrim parasysh.

Kryesuesi, atëherë po votojmë kush është që kjo pikë të shkojë në diskutim publik me propozim që të plotësohet propozim-vendimi?

Kuvendi me 21 vota per, pa abstenime vendosi që Plani Zhvillimor për Istog të shpallet në diskutim publik më propozim të Naim Imeraj.

Obligohet shërbimi për punë të KK-së, nenit 2 te Propozim-Vendimi, t'i shtohet edhe pika 3, dëgjim publik në Rakosh dhe Stardran.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Radoš Repanović, Radenko Belošević, Slaviša Maliković dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër (tetor-dhjetor) 2018. Fjalën ja kaloj Kryetarit.

Kryetari, fjalën ja kaloj Osman Sadikajt për prezantim të Raportit financiar për tremujorin e katër (tetor-dhjetor) 2018.

Osman Sadikaj, përshëndeti të pranishmit dhe bëri prezantimin e raportit.

Kryesuesi, fjalën ja kaloj Naim Imerajt, Agron Avdijajt pastaj Naim Behlulajt.

Naim Imeraj, falënderon për fjalën. Rendin e ditës e kemi rapporti finanziar për tremujorin e katër po përpinqem që mos të merrem më gjithë vitin por po merrem me kontributin e tremujorshit aktual tator-dhjetor 2018 dhe realizimin e planit çoftë për të hyrat vetanake, grumbullimin e te hyrave vetanake, burimet e financimit të shpenzimeve të tyre. Besoj që kjo është një qasje në rregull duke marrë parasysh faktin se ne zakonisht në fund të muajit mars e kemi obligim që të miratojmë raportin vjetor e aty kemi hapësirë me mundësi që të merremi me të gjitha periudhat. Po filloj me të hyrat vetanake, ZKF-ja i dha pozicionet për gjithë vitin e unë po merrem vetëm me konstatimin që kontributi tremujorshit katër në grumbullimin e të hyrave vetanake ka qenë 19,2% te kodi 21. Qe nëse ju kujtohet kolegëve kam qenë entuziast që ajo që nuk ka ndodhur me tre mujofshin me parë do shpresojmë që të arrijë të kompensojmë. Kjo po shihet që nuk kemi mund me mbërritje kompenzu at hapin e grumbullimit të mjeteve në tremujorhat paraprak edhe tremujroshi i katër pavarësisht 20% nuk kemi mund me mbërritje dhe na del që grumbullimi në raport me planin vjetor është rreth 91% në kodin 21 përkatësisht me tejkalimin e planifikimit të grumbullimit të gjobave të komunikacionit, agjensionit pyjeve dhe gjobave nga gjykatat në përafërsisht 7,3 % nga të planifikuarat. Prapë se prapë e bjen realizimin në 93,21 %. Shpresoj që në planifikimet vijuese do ta kemi parasysh se gjithmonë po themi që kemi pasur problem me planifikim kur po vjen puna në planifikim po i gjejmë do arsyetime që po na vjen prej kornizës afatmesme buxhetore. Unë e dijë në vazhdimësi prej se jam këtu administrata nuk ka mund të shkoj përtjerë këtyre për shkak se ne kemi dhenë një planifikim që ka qenë i paarritshëm. Kërkoj falje që po i referohem administratës por është e para në rend por është një diçka e saktë. Duhet ulur dhe jo të t'i quesim aty ku pritet që ka hapësire. Duke e marrë ekspansionin e ndërtimit në Komunën e Istogut nuk është e habitshme ajo që ne të tejkalojmë më 150% numrin e leje të ndërtimit. Por ne prapë se prapë duhet të shohim se çka po ndodh edhe Istogu si vend atraktiv për banim për shumë shkaqe, të kemi një planifikim të mirëfilltë edhe në aspektin e asaj. Problematika tjetër është ajo e mosarritjes së planit e nuk po flasim për faturim e të hyrave nga tatimi në pronë. Nëse ne këto nuk mundemi me i mbërriti sot qysh do t'i mbërrijmë kur nesër në këtë kategori do të shtohet edhe tatimi në tokë. Është një sfide e cila vitin 2019 e bënë eksperimental jam shumë i bindur. Por me shpresë do ta përballojmë edhe këtë sfidë. Kaq sa i përket të hyrave vetanake. Sa i përket burimeve të financimit jam përpjekur të bëjë një shkoqitje dhe të nxjerri kontributin e tremujorshit të katërt. Nga totali i përgjithshëm i shpenzimeve vjetore që e kemi arritë së bashku me paga edhe të hyra vetanake edhe të hyra vetanake të bartura, grantet dhe grantet nga qeveria dhe USAID, vlerësimi im nga kalkulimet del se e kemi shpenzuar planin vjetor me 90,7%. Po është një diçka nëse e veçojmë vetëm tremujroshin e katërt del se 41,1 % shpenzime i keni bëre pa paga edhe del se 51% plus ato që nuk janë shpenzuar por çka keni mbërritje i shpenzuar janë 51% e buxhetit. Më të vërtet është një dinamike vrasëse që e ka një arsyetim eventualisht për kategorinë e shpenzimeve kapitale por jo aq shumë për

Procesverbal

mallra dhe shërbime për subvencione transfere. Mallra dhe shërbime 42% janë shpenzuar në tremujorin e katërt, 34% të shpenzimeve komunale, 35% të subvencione dhe transfere dhe 56% shpenzime kapitale. Besoj se jam i saktë për shkak se janë shfrytëzuar shënimet të cilat kanë qenë në dispozicion e që të merr pak kohë por është kënaqësi me qellim që në të ardhmen kjo përqindje të zvogëlohet. Unë e dijë që të kategoritë është problematika e buxhetimit, problemit e të hyrave vetanake që nuk dihet sa i kemi apo i shpenzojmë apo si shpenzojmë. Pastaj mos me keqkuptoni po "ajo loja politike", që nuk e kemi problem që shpenzimet e të hyrave vetanake mund t'i përcjellim në vitin e ardhshëm, tani ndonjë projekt që ka qenë jo shumë interesant mundem me i bart ato mjete në ndonjë projekt që mundet me pas ndonjë prioritet por edhe që na intereson më shumë. Mirëpo nuk mundem me arsyetuar që të hyrat vetanake, të bartura prej vitit 2016-2017 janë shpenzuar vetëm 44% dhe kanë ngel 56% të pa shfrytëzuara prej 2016, 2017 në 2018. Me të vërtetë vjen në shprehje me mëndu a jemi duke bërë menaxhim të mirë apo jemi duke bërë politika. E kam thënë edhe në kontributin tim në tremujorëshin e kaluar, mundet të jetë kalkulim që ato mjete me qenë një rezervë se jemi në rrjedha shoqërore të papërcaktuara nuk e kemi stabilitetin shoqëror e na nevojiten për vitin e ardhshëm, se mundet me na ra Bajrami në Ramazan edhe na qëllojnë aty, gjë që kisha mund edhe vet më bere. Nëse është në pyetje menaxhimi në instanca prokuroriale, në menaxhim, në planifikim është e pafalshme dhe besoj që dikush duhet të jap përgjegjësi.

Agron Avdijaj, faleminderit për fjalën, disa gjera që i përmendi Naimi nuk kisha dashtë të ndalem. Megjithatë tejkalimi i inkasimit është mungese e planifikimit konsideroj. Nuk është hera e parë që ndodh se edhe në tremujorin e parë kemi pasur çalime të tilla është mirë të jemi edhe më ambicioz. Nganjëherë është ma mirë mos me arritë se me tejkalu, se të tregon se nuk jemi komunë ambicioze. Është mirë më qenë edhe objektiva me ambicioze. Edhe sa i përket shpenzimeve që bëhen në tremujorin e fundit konsideroj ndoshta që të projektet kapitale e ka një arsyeshmëri për shkak që kryhen në fund. Mirëpo shtrija e menaxhimit të jetë mujore konsideroj së është më efikase. Nëse mbesin në fund pastaj edhe presioni ndaj stafit jep mundësi që ju të gaboni vazhdimisht për këtë arsy planifikimi në mënyre sistematike me i paraparë shpenzimet edhe si komunë do jeni shumë më mirë në realizim të buxhetit. Janë disa kategori të shpenzimeve që për mua janë shqetësuese ndoshta keni edhe ju ndonjë arsyetim, shpenzimet për dreka zyrtare gjatë vitit 2018. Nuk e dijë a është finale është 45 mijë euro. Me llogaritë në ditë punë i bijë 182 euro dreka zyrtare për çdo ditë, me kthy në racione ditore të një punëtori i bien 2.5 euro, i bien mbi 73 racione në ditë është fjala për kuptimin e një racioni normal.

Osman Sadikaj, unë e kam sqaruar pse ka ndodhur kështu tremujorin e kaluar e kemi pasur një borxh për Troften me herët dhe është dashur me pagu. Për këtë është ngrit vlera. Ndërsa siç e shini edhe vet në tabele i keni të shënuara. Kësaj radhe e kam punuar edhe për çdo muaj ku janë bërë shpenzimet për secilin kod ekonomik, në total e nxjerr shumë mirë prej ekselli. Në total nuk e kemi mbërri planin 93 mijë euro. A është bërë plani mirë sipas programit buxhetor dhe sipas obligimeve që i kemi nuk është bërë

mirë. Këtë e kemi thënë edhe në tre mujor. Shpenzimet që kanë ndodhur përvçe kapitaleve në periudhën e fundit, tjerat kanë shkuar në trend të përqindjes pér 1/4, si pér mallra dhe shërbime si pér subvencione por komunalit janë pjesë që ne nuk mundemi me bërë shpenzim pa bërë shpenzime.

Kryetari, rend ditë është tremujori i katërt nuk dua të ja hedh fajin askujt pér këtë ngase me shumë është nga brenda edhe pse ka faktor të jashtëm. Te planifikimi nuk e kam parë si problem. U përmend administrata, çka ki me planifiku? Ka të drejtë Naimi plotësisht, ka mundësi të tatimi në pronë edhe të asetet e komunës. Këto janë mundësitë që mundemi me i rritë të hyrat vetanake. Ndërsa të ndërtimi vërtet nuk e kemi pritë që të rritet interesimi në ndërtim, kjo mua po me çudit, në çdo vend është në rënjë e në Istog është ngritë. Tash se di sa janë paraparë pér vitin e ardhshëm të shohim. Unë propozoj të behët një analizë ma detale, projekt pér projekt, çka janë vonuar në mënyre që të jemi të gatshëm t'i prezantojmë. Unë nuk jam i gatshëm në detale.

Naim Behluli, përshëndeti të pranishmit, unë jam shumë jam i interesim pér këtë vlerën 100 mijë euro? Desha të dijë a është mos planifikimi i duhur apo çka është problemi? Sepse më këtë disa projekte ishin realizuar, Kryetari i dha disa sqarime.

Naim Imeraj, kërkoi falje se nuk kam dëshirë me repliku por besoj jemi diçka duke sqaruar. U përmend nga ZKF, një lloj proporcionaliteti mirëpo te mallrat dhe shërbimet pér mua personalisht është e papranueshme që në tre tremujorët e parë ka qenë 45,1% shpenzime në mallra shërbime kategoria, ndërsa vetëm në tremujor të fundit 42%. Ky është problematika nuk u kapa pér projektet kapitale, se me të vërtetë e kanë problematiken pak a shumë mundem me ditë, të cilën e përmendni edhe Kryetari dhe mosfunkcionimi i zingjirevë atë sistemin që ku shkëputet krijon probleme. Nuk është bërë projekti dhe mandej duket me improvizuar që na bënë më dyshuar ka qenë kualiteti paramasat apo është diçka tjetër. Te mallrat dhe shërbimet është jo një koeqillëk, nuk mund t'i them diçka tjetër pos një jonikoqirllëk. Nëse ka sqarim tjetër, ju lutem?

Osman Sadikaj, kur vjen raporti tjetër do del mbi 1 milion euro ngase këtu nuk janë të futura, 131 mijë euro te pagave, 325 mijë euro janë nga granti qeveritar që kanë shkuar suficit dhe nuk kthehen. Ndërsa 291 mijë, 272 mijë, 14 mijë do jetë pikë e rendit të ditës pér mjete të bartura. Ne kur i shtojmë edhe këto sufici i do të dalë 455 mijë euro në raport financier nga granti qeveritar, që nuk kthehen. Kur vjen raporti financier do ta kapë shifrën 1 milion euro i pashpenzuar, që çdo vit ka qenë 91, 92% dhe shpenzimi të totali i buxhetit që asnjë komunë nuk mundet me shpenzuar 100% buxhetin.

Kryesuesi, fjalën e ka Arif Elshani.

Arif Elshani, pse humben 300 mijë euro, shkuan suficit e që unë e dijë që katër vitet e fundit keni qenë të kujdesshëm që parat mos të humbin, pse humben ato? Unë mendoj se ish dashtë të merret përgjegjësi nga këta njerëz. Unë mendoj se ky suficit është

Procesverbal

humbja më e madhe e Komunës së Istogut në pesë vitet e fundit. Sa i përket mallra dhe shërbime, pse i latë pa i paguar Troftes 21 mijë euro deri në fund të vitit? Kur paratë i ke pasur, të alokume i ke pasur, a vetëm për një nënshkrim? A vetëm për të shkuar të Smajli me i thanë ma qet një drekë apo çfarë? Unë mendoj së vartësit e tu z.Kryetar duhet të jenë më të kujdeshëm. Tani unë po dyshoj pse nuk janë paguar deri në këtë kohë. Pse paguhet servisimi i veturave në fund të vitit, kur mundesh me fatura? Është afati i pagesë, ai nëse dëshiron mundet edhe kamatë me vendos. Unë mënoj se menaxhmenti duhet të jetë më efikas dhe mos te mbresin kështu gjërat.

Arben Kabashi, edhe unë e kam vërejtjen tek projektet kapitale. U përmenden përgjigjet dhe pyetjet, thjeshtë ne po e dimë ku është defekti. Defekti është të planifikimi i dobët. Ose mos planifikimi i mirë i viteve më herët. Buxheti i realizuar është 57% me projektet kapitale me paralogaritë që kam bërë unë. Ato mjete të cilat nuk shpenzohen shkojnë në suficit dhe prapë them planifikimi është i dobët. Prandaj edhe punët ne teren janë të dobëta për shkak së në fund të vitit nuk realizohen në tërësi të gjitha punët. Nuk dua të ndalem të hyrat vetanake ngase u përmenden të gjitha dhe presim raportin final.

Kryetari, në mars do të potencojoj por tani po them se komunës tonë pas datës: 24 dhjetor 2018, nuk ju është lejuar asnjë projekt ndërsa komunave tjera ju është lejuar. Edhe me datën: 31 dhjetor 2018, ju është lejuar të behën pagesat dhe unë shpesh po bëjë pyetjen se çfarë po ndodhë koalicioni me PDK. Unë i thash edhe Kryeministrin këtu në Istog dhe ma jepi fjalën se do të na lejoj por kjo nuk ka ndodhur.

Kryesuesi, fjalën ja kaloi Arif Elshanit.

Arif Elshani, unë mendoj së çka të vijë pas datës: 23 e 24, janë të momentit që ndryshojnë por mendoj se këtë vit duhet të planifikohet me mirë dhe mos të vijmë në këtë situatë. Ka kohë të mjaftueshme dhe mandej shqetësimi është pse? Problemi është brenda.

Kryetari, këtë që thashë tani është e saktë dhe pajtohemi.

Agron Avdijaj, më vjen mirë kur e pranonin një defekt mirëpo në anën tjetër e dini dhe prapë vazhdohet ashtu vit pas viti. Ideja është të përmirësohem.

Kryesuesi, fjalën i kaloi Ajshe Metajt.

Ajshe Metaj, u fol shumë dhe nuk dua të ndalem shumë. Sufici po shihet së në krahasim me vitet e kaluara është i madh. Arsyjeja është krejt te planifikimi. Duhet të ketë kujdes në planifikim edhe në menaxhimin e realizimit të projekteve sepse nëse menaxhohet mirë, teprica do të jetë në një përqindje më të vogël. Siç u tha paraprakisht as ne si komunat tjera nuk mund të realizojmë buxhetin qind për qind por me qenë së ka mbetur një shumë e madhe mendoj që duhet menaxhuar më mirë. Kisha pyetje se a

kishim mund para datës: 23 dhjetor 2018 për alokimin e këtyre mjeteve? Edhe çështja e koalicionit e përmendi Kryetari, kur ju behet boll atëherë jemi këtu.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi, vazhdon me pikën e pestë të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të punës të Kryetarit për vitin 2018. Fjalën ja kaloj Kryetarit.

Kryetari, besoj e keni lexuar këtë material. Ajo që është punuar është këtu njësoj sikurse raporti finanziar. Ka lëshime ka vërejtje dhe jam i gatshëm për pyetjet e juaja.

Naim Imeraj, dy çështje janë të cilat z.Kryetar, kam mund me i vërejtur ndoshta pak sipërfaqësor. Se pari lista e lejeve të ndërtimit që është pjesë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Kadastër, besoj se duhet të jetë me transparente dhe e përditësuar në bazë ditore dhe jo si po vjen tani në bazë gjashtë mujore. Mund të jem gabim por kemi marrur përgjegjësi të jetë e prezantuar publikisht në ueb faqen e komunës dhe të jetë e përditësuar në baza ditore. Këtë e keni marr përsipër mandatin e kaluar nëse jam i gabuar jam i kënaqur, po shumë mirë që është në këtë material por ish dashtë të jetë transparentë për të gjithë në bazë ditore. E gjithashtu është edhe obligim që del nga ligji i ndërtimit. Dhe ju rikujtoj se keni mbetur borxh në vazhdimësi kur kemi fol për reportin e kryetarit komunës, që rregulloret të cekën. Baza ligjore e punës së secilës drejtori të ceket, nuk është filozofi e madhe që secili drejtorat të marr këtë hap. Unë besoj së ja kishim ngrit vlerën dhe kishim bërë një kornizë të unifikuar. Ka drejtorate që e cekin thotë punojmë në bazë të ligjit, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative. Unë besoj se njerëzit që punojnë dhe kanë përgjegjësi të caktuar ndaj ligjit i dinë ato dhe nuk e kanë shumë problem me i shtuar tri fjali të cilat i referohen asaj baze ligjore. Dhe se fundi është vlerë e shtuar. Po insistojë në vazhdimësi dhe nuk është hera e parë që po e them, është vlerë e shtuar. Edhe e treta, në planin e punës së KK-së, e kemi miratuar në një muaj të caktuar dhe me siguri keni informatën. Një pikë e rendit të ditës dhe e kam kaluar edhe në mandatin e kaluar, që ka të bëjë më zbatimin e rregulloreve komunale. Cilat rregullore komunale janë në fuqi dhe cila është shkalla e zbatimit dhe cilat janë pengesat.? Unë besoj së është voluminozë por ta dimë se cilat janë dhe cilat janë sfidat. Sepse kemi rregullore të cilat veç i kemi bërë dhe nuk ka ndodh asgjë sepse ka rënë në konflikt të mëvonshëm me legjislacion tjetër ligjor dhe janë rrezuar, mos t'i përmend tani cila e cila. Po ish kanë mirë me i qartësuar. Edhe se fundi ekzekutivi e ka për obligim për të raportuar. Besoj kish me qenë mirë që tani mu përgatit për këtë. Faleminderit Kryesues dhe kaq kisha sa i përket këtij rapporti.

Kryetari, çështjen e parë që e përmende e mora me vërejtje me vend dhe nuk kam kurrrfarë arsyë të mos postohen në ueb faqe. Kjo duhet të shkojë kështu, ka rregullore që është aprovu në kuvend me vite me herët dhe ndoshta nuk është prek në zbatim. Ka rregullore që janë aplikuar pjesërisht dhe ka që kanë rënë në ndesh me ligjet që kanë ardhur më vonë. Se rregulloret që aprovohen shqyrtohet ligjshmëria nga MAPL-ja.

Procesverbal

Nëse nuk është fut në legjislaturë të rendit të ditës atëherë kërkoj dy muaj që të përgatitën për të raportuar. Pasi është në plan atëherë do të përgatitet ky raport.

Agron Avdijaj, meqenëse materiali është voluminoz nuk kam mundur të trajtoj gjithë këtë por në disa pika kisha dashtë të ndalem në pikën që lidhet me transparencën dhe debatet publike. Lind pyetja a e keni shqyrtuar se pse njerëzit nuk marrim pjesë në debate? Sepse ka mundësi me analizuar këtë pse njerëzit nuk marrin pjesë në debate? Mendimi im është së kjo është problem edhe në komunat tjera. Në bazë të studimeve është se jo pse nuk kanë interes për projekte dhe punë është se nuk kanë besim se zëri i tyre dëgjohet. Kur i inkurajoj të marrin pjesë për mbledhje, thonë se nuk dëshirojnë.

Kryetari, ne i ftojmë publikisht me shpallje përmes radios dhe nuk besoj së është çështja e besimit. Unë po e shohë edhe në teren nuk vijnë shumë, me herët nuk i ka zënë salla.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Arif Elshani.

Arif Elshani, Unë mendoj së aty ku duhet më se shumti transparenca aty shihen vetëm tri fjalë. Vetëm thotë kaq i kemi bërë e si kanë përfunduar nuk është me rëndësi? Në punë e kryetarit të komunës unë mendoj së ajo drejtoria më së tepërmqi që duhet të menaxhohet më se miri të menaxhohet, të monitorohet të shikohet së çfarë po ngjanë. Aty është vërejtja ime në punë, ka edhe diçka të vogla por kjo është. Pse nuk shënohet në raport që Zyra e prokurimit nuk e inkason sigurimin e ekzekutimeve ose garacionin e dy mijë eurove për projekt te viteve mbrapa dhe ajo humb.

Arben Kabashi, është një vërejtje që e kam bërë çdo here. Tjetër gjë shënon në raport të punës se Kryetarit e tjetër është e realizuar. Tash sa është Kryetari menaxhues i mirë e sa është përcjellës i atyre punëve. Një pjesë e madhe e projekteve që janë në teren të shënuara se janë të përfunduara janë te dështuara. Ketë ta vërtetoj me dokumente, me raport, me foto. Kemi një dispalancë në mes raportit të punës dhe realizimi që ka ndodhur në teren. Sa jemi përgjegjës drejtoroatet unë mendoj se përgjegjësia hedhet tek ato direkt. Nuk e përcjellin trendin e punëve që bëhet aty. Thjeshtë defekti të drejtoratet te komisionet e pranimit dhe te mbikëqyrësi. Do të thotë kemi një raport që është i mirë edhe me lexu por realiteti është tjetër.

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Kryetarit pastaj Ajshe Metaj.

Kryetari, nuk mund të pajtohem më këtë konstatim. Është konstatim i vrazhdë i padrejtë dhe i pa saktë. Nuk kam asnijë koment tjetër.

Arben Kabashi, ne mund të shkojmë bashkë dhe shofim realizimin e punëve në teren, një pjesë e madhe e tyre janë si them unë.

Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit dhe nga rapporti që e kam analizuar kam shkoqit disa raste. Në sektorin e shërbimit civil, thuhet se funksionojnë pesë zyra të

vendit dhe në realitet janë vetëm tri funksionale. Arsyja pse nuk funksionon në Vrellë e dimë se punëtori fatkeqësish ka vdekur dhe nuk është zëvendësuar. Ka kërkesa që ky vend të plotësohet edhe pse thuhet se ekziston shërbimi online por qytetarët nuk po munden t'i kryejnë shërbimet si duhet. Desha të pyes lidhur me këtë vend a do të shpallet konkursi? Edhe në Drejtorinë e Inspeksionit ka shkuar punëtori në pension edhe aty ka mungesë, a mund të zëvendësohet ky punëtor apo jo? Sa i përket inspektorit është shumë e rëndësishme me qenë duke pasur parasysh situatën që jemi. E kemi parasysh aferën e mishti në Pejë që ndodhi. Edhe dua të di për arkivin e qytetit a është brenda komunës këtu, ku është dhe sa punëtor janë? Në sektorin e arsimit i kam dy a tri pyetje? Në listat që kanë ardhur nuk figurojnë vitet e punës dhe faktikisht na mungojnë dy vite e gjysmë, a duhet të evidentohen këto vite apo si është puna? Edhe një herë e kam debatu çështjen e pagave jubilare dhe çështjen e tri pagave? Desha të dijë a i kanë marrur këto paga?

Kryetari, çështja e Inspektorit të veteranës nuk është kompetencë e komunës fare. Ne e kemi një veteranar të punësuar më kontrate të cilin AVUK nuk e mer si punëtorë por ka mbet te ne. Ai këtë detyrë e kryen dhe detyrat i merr nga komuna. Kemi kërkuar të na mundësojnë të marrim një punëtorë por nuk është fajti jonë. Të çështja e arsimit ato tri rroga të ju japidh ata që e kanë nënshkruar kontratën.

Edona Bujupi-Loxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës përshëndeti të pranishmit, sa i përket Zyrave të gjendjes civile për momentin janë tri funksionale. Ne vitin e kaluar i kemi pranuar dy ofiqarë njëri është për Dobrushë ndërsa për Zyrën e vendit në Vrellë, do të hapet në korrik ose gusht. Mirëpo kemi një problem këtu ngase duhet të bëhet licencimi i zyrtarëve, duhet të bëhet një vitë përvojë punë pastaj t'i nënshتروhet një testi dhe nëse e kalon atëherë është në rregull. Kjo nënkuption që edhe nëse e marrim tanë prapë se prapë asnëri nga ofiqarët nuk mund të punojë. Janë e-kiosket të cilat po e kryejnë funksionin shumë mirë dhe nuk besoj se ka pasur ndonjë problem. Sa i përket arkives së komunës, funksionon në kuadër të Drejtorisë së administratës dhe është e vendosur në objektin e Shtëpisë së Kulturës dhe gjithsej janë tri punëtore. Është udhëheqësja e sektorit së bashku me dy zyrtare tjera dhe punën e tyre po e kryejnë me përgjegjësi.

Ajshe Metaj, drejtoreshë unë po kërkojë të zgjidhet një punëtorë që të mbulojë atë vend punë. Unë e dijë së ka qenë një konkurs, po kërkoj vetëm të mbulohet ai vend punë. Unë nuk mendoj se online munden të pajisen me dokumente të gjithë qytetarët aty.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Naim Behluli.

Naim Behluli, falënderoj për fjalën dhe nuk pajtohem më kolegët e mijë së sipas tyre po del gjithçka zi e faktikisht nuk është ashtu. I përgëzoj drejtorat që po e dhënë maksimumin për të ju dalë në ndihmë qytetarëve në çdo aspekt. Kemi rastin e drejtorit të shërbimeve publike, i cili nuk ka lenë rrugë pa ju dalë në ndihmë qytetarëve. I përgëzoj dhe uroj të vazhdojnë me punë.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj, përshëndes kolegun dhe i them se ne nuk shofim vetëm zi por mundohemi me kontribu për tu përmirësuar ngase jemi të thirrur këtu për qytetarët.

Kryesuesi, shtjerrim debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me pikën e gjashtë të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018. Bazuar në rregulloren e punës KK-së, statusin dhe LVL, kemi obligim të hartojmë reportin e punës dhe të njoftojmë ministrinë lidhur më atë së çfarë kemi punuar. Në raport janë të përfshira, përbërja e KK-së, struktura dhe përfaqësimi në KK, komitetet dhe këshillat e KK-së. Punë dhe aktivitetet e KK-së dhe trupat të saj, marrëdhëniet e KK-së më institucionet qendrore, lokale dhe organizatat tjera, sfidat e KK-së. Nëse dikush nga ju keni diçka mund të plotësojmë më vërejtjet dhe sugjerimet tuaja. Fjalën e ka kërkuar Lavdije Bujupaj dhe Arben Kabashi.

Lavdije Bujupi, përshëndeti të pranishmit, në pikë të shkurtra dua të ndalem te rapporti. Shihet së janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktivitetave të KK-së. E vlerësojë shumë paraqitjen konkrete të përfaqësimit të grupit të grave asambleiste në dy komitetet më të rëndësishme të KK-së, KPF dhe Komitetit për Komunitete. Vërehet së në këto komitete ka një ngritje të pjesëmarrjes së grave dhe diçka tjetër që e vlerësojmë ne si grup i grave asambleiste ku në reportin e juaj thuhet së 90% e grave në KK nuk kanë ardhur përmes kuotës gjinore por përmes votës së tyre. Raporti nuk i anashkalon edhe tre asamblist të cilët vazhdojnë të qëndrojnë të pa certifikuar në ulëset e kuvendit. Kam pyetje lidhur me këshilltarët që mungojnë, pagesat e tyre a do të bëhen retroaktive? Nëse po a ju paguhen edhe mëditjet? Deri kur do të vazhdojë kjo padrejtësi, a ka menduar dikush nga KK që tu jepet e drejta e fjalës, po pa të drejtë vote? Duke e ditur se certifikimi i tyre tashmë është vetëm një formalitet? A janë informuar këshilltarët lidhur me pikat e rendit të ditës dhe seancat? Në raport përmendet se janë marrur disa vendime, keni miratuar tri projekt rregullore komunale. Shpresoj këto rregullore të janë të zbatueshme ngase shumica e tyre në mandatin e kaluar nuk kanë gjetur zbatueshmëri. Nuk do ishte mirë të krijohet bindja që në këtë KK po miratohen rregullore vetëm për sy e faqe.

Arben Kabashi, unë i pash dy raportet e vitit 2017 dhe tani. Kur po i bëjë kahasimet ka dallime të mëdha. Nuk shënon askund sa pyetje janë bërë në KK, cila pyetje cila temë. I kemi pasur të përshkruara në raporte tjera. Sa i përket rregulloreve, vendimeve këto janë përgjegjësi e vet ekzekutivit. Marrëdhëniet e KK-së më institucionet tjera, nuk kemi pasur ndonjë reagim diçka dhe as në të kaluarën. Ka pasur pyetje dhe tema që i kemi ngritur vitin e kaluar por thjeshtë nuk janë në reportin e punës. Këto shënon se janë

Procesverbal

marr vendime unanime, këtë e kisha heqë sepse ka pasur edhe vendime jo tilla. Do të thotë ka pas vend përmirësim.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Naim Imeraj.

Naim Imeraj, faleminderit për fjalën, zakonisht raporti i punës bazament e ka një planifikim paraprak për të cilin kemi qenë të hendikepuar. Për këtë e mora fjalën të them se na ka munguar për shkak të zhvillimeve shoqërore të fundvitit 2017 mandej legjislatura paraprake nuk ka arritur me bërë planin e punës. Ndoshta me iniciativë edhe kemi mund ta bëjmë në janar dhe mandej me vazhdu por ka shkuar si ka shkuar. Kemi vazhduar dhe kemi punuar mirë, nuk ka ideale asgjë për qefin ë të gjithëve por përgjithësisht është korrekt. Besoj i merrni me dashamirësi vërejtjet e dhëna.

Kryesuesi, pyetjet që ngriti Lavdija. Është shqetësim edhe i gjithë neve, çështja e atyre tre këshilltarëve të KK-së është e dhimbshme. Kjo është e njohur se anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor nuk janë të licencuar dhe nuk janë funksional. Pyetjes Lavdise nuk mund t'i jap përgjigje, ajo më shumë është çështje juridike. Ata nuk marrin pagën as mëditjen, derisa nuk e kanë dhënë betimin. Nuk janë të vetmit këta, janë edhe në Komunë e Pejës dy dhe në komuna tjera. Lidhur me zbatimin e rregulloreve ka filluar zbatimi i tyre dhe do të keni report. Pyetjet dhe kërkesat e Arbenit do të përfshihen në report. Nëse nuk ka dikush diçka mbetet që ky report të plotësohet dhe mbetet në arkivin e kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi, vazhdon me pikën e shtatë të rendit të ditës: Shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores Komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba. Kjo rregullore aprovohet çdo here në fillim të vitit. Unë kisha kérku nga drejtori që të na laborojë këtë.

Hysni Maxharri, kam vetëm një sqarim, ato që janë të hijezuara më ngjyrë të verdhë shtohen dhe janë propozuar nga komisioni të vendosen në rregullore ndërsa ato më ngjyrë të kuqe janë të propozuara të largohen. Për këtë do diskutojmë pasi mbahet dëgjimi publik.

Kryesuesi, atëherë është e qartë kjo dhe kjo rregullore kalon në diskutim publik, pasi nuk ka diçka në lidhje më këtë po votojmë.

Kuvendi më votim unanim, pa asnje votë kundër dhe pa abstenime shpall në diskutim publik Projekt-Rregulloren Komunale për taksa ngarkesa dhe gjoba.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Radoš Repanović, Radenko Belošević, Slaviša Maliković dhe tre anëtarë të kuvendit, të cilët ende nuk janë certifikuar.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi, vazhdon më pikën e fundit të rendit të ditës: Pjetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Edhe pse kjo pikë vetëm u konsumua nga disa anëtar të kuvendit. Unë pyes a ka dikush diçka lidhur më këtë pikë? Fjalën e ka kërkuar Lavdije Bujupaj pastaj Arif Elshani.

Lavdije Bujupaj, pyetja imë është për drejtorin e shërbimeve publike. Kane kaluar disa muaj dhe në këtë Kuvend u mor vendimi që pagat për punëtorët e Stacionit të Autobusëve të jepen në mënyre retroaktive, kjo nuk ka ndodhur? Cili është problemi dhe kur pritet që punëtorët të marrin ato paga? Cila është gjendja aktuale dhe a ka diçka pozitive apo njëjtë? Këtë e bëjë ngase tani kemi inspektor dhe po shpresojë së situata është më e mirë.

Arif Elshani, faleminderit Kryesues. Unë kam bërë një kërkesë para dy muajve dhe kërkesa ime e parë është lidhur me Banjën. Kérkoj nga ju dhe ekzekutivi që në të ardhmen Banjës t'i behet zgjidhja e problemit të ujit pasi që në Banje nuk ka ujë. Kam pasur edhe një kërkesë dhe kam kërkuar sqarim rrëth mbulesës së shpenzimeve për të vdekurit për ata që jetojnë më ndihma sociale. Këtu më shënon që nëse dikush ka paraqit kërkesë ka mund t'i marr. Unë asnjë shpenzim nuk i kam parë që dikush ka marr mjetet për këtë, unë kérkoj që kjo të jetësohet në vitin 2019 dhe ata që janë në asistencë sociale t'i jepen 150 euro. Për të verifikuar ka metoda të ndryshme. Dhe pyetja tretë, Qendra urbane e Staradranit nëse mbetet te merë epitetin e qendrës urbane.

Kryesuesi, fjalën e ka Arben Kabashi.

Arben Kabashi, unë kam disa pyetje. Dy pyetje i kam për mësimdhënës për Drejtorinë e Arsimit. Pyetja e parë është si është mundësia dhe në bazë të çka është zgjedhe mësimdhënësi i vitit. E dyta pagat jubilare, ne e dimë së në mars të vitit kaluar e ka mor obligim komuna. Ndërsa për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me intereson se 10 mijë euro kanë qenë të planifikuara për not, si është bërë përzgjedhja e nxënësve dhe a janë planifikuar në tërsi këto mjete? Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ne e dimë se komuna nuk ka kontraktuar kompani për mirëmbajtjen e rrugëve lokale në sezonin dimëror, thjeshtë me intereson nga cila kategori do të paguhen ato mjete. Nëse ka pasur kompani?

Agron Avdijaj, sqarim nga drejtori i arsimit. Kohëve të fundit ka disa muaj është tu ekzistu një konflikt si në heshtje dhe më duket se është duke pasur shqetësim në Gjimnazin "Haxhi Zeka", në Istog. Kam të dhëna së është kërcënuar nga vetë profesorët edhe drejtori i shkollës. Besoj jeni në dijeni, ka kërcënime ndërmjet profesorëve dhe ka padi. Me intereson nga drejtori të dijë se a është në dijeni për këtë dhe a ka ndërmarrë ndonjë masë. Janë trajtuar edhe disa raste të rrahjes së profesorëve a e ka trajtuar ndonjëherë drejtoria këtë si problematikë apo jo?

Procesverbal

Kryesuesi, fjalën ia kaloi Enver Rugovës.

Enver Rugova, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike përshëndeti të pranishmit falënderon për pyetjen. Kompania që ka qenë për mirëmbajtjen e rrugëve të asfaltuara verore dhe dimërore, në tector e kemi shpall me kohë dhe gjatë procedurave është anku kompania që nuk ka qenë e kënaqur më operatorin që e ka fituar punën dhe lëndën e ka fituar në OSHP. Rezultat i kësaj e kemi edhe një suficit dhe po presim përgjigje nga OSHP. Sa i përket kompanive të angazhuara ato janë paraqit vullnetarisht dhe ne ju kemi dhënë itinerarin. Ka pasur raste vdekje dhe e kemi aktivizuar edhe kamionin por bllokada në rrugë nuk ka pasur.

Kryesuesi, fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi, Drejtor i Drejtorisë për Arsim përshëndeti të pranishmit. Pata pyetje rreth zgjedhjes së mësimdhënësit më të mirë të vitit, ne e kemi pasur një kërkesë nga ministria dhe jam konsultuar më disa njerëz sepse rregullorja njeh procedura tjera. Ne e kemi përzgjedh një mësuese dhe nuk besoj së është bërë ndonjë shkelje. E dyta pyetje për mësimdhënësit jemi në dijeni për të gjitha ato që kanë ndodhur në gjimnaz, nuk është gjendja aq alarmante mirëpo janë disa probleme mirëpo jemi në pritje. Pagat jubilare janë duke i marr dhe kanë filluar janë në sistem.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Ajshe Metaj dhe pastaj Drin Sadikaj.

Ajshe Metaj, ju e tregut procedurën e përzgjedhjes së mësimdhënësit të vitit dhe ajo që është përzgjedhur nuk kam asnjë kundër por kisha thëne se nuk është e rastit pasi që shpalen çdo vit punëtoret e vitit. Mundësish herëve të tjera të respektohet rregullorja dhe unë e mendoj se ish dashtë më shumë kohë më punu për të qenë punëtore e vitit.

Drin Sadikaj, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë dhe Sport përshëndeti të pranishmit. Ka qenë 10 mijë euro projekti dhe janë përzgjedhur 350 nxënës dhe lista ka ardhur nga drejtorat e shkollës.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora, 14:15.

Prosesmbajtëse,
Arlinda Kurçaj

Arlinda Kurçaj



Kryesues,
Qaush Balaj